

Qasja klinike ne diagnozen e vaskulitit te retines

Vaskuliti i retinës është një gjendje inflamatore segmentit posterior okular që përfshin enët e retinës dhe perfaqeson një kërcënim për shikimin. Zbulimi i vaskulitit të retinës bëhet klinikisht dhe konfirmohet me ndihmën e angiografisë me fluoresceinë të fundusit okular. Vaskuliti aktiv karakterizohet nga eksudate perreth enëve të retinës që rezultojnë në mbështjellje me ngjyre të bardhë në formën e manikotave të enëve të prekura. Në këtë punim, diskutohet një qasje praktike për diagnozën e vaskulitit të retinës bazuar në gjetjet e angiografisë së fundusit.